REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 284/1 Prot.

Lushnje më, 10/01/2024

PROJEKT-VENDIM

NR. 06 DATË 10/01/2024

"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA SIPËRFAQEN PREJ 500 M² TË NGASTRËS NR. 1/B, E CILA BENË PJESË NË EKONOMINË PYJORE BALAJ-MOLLAS, NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KARBUNARË."

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2023 në mbështetje të: nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma "e", pika 1 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM-së nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive,"të ndryshuar, nenit 801 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", me kërkesë të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtorisë Juridike:

PROPOZOJMË:

I. Të miratoj dhënien me qira sipërfaqen prej 500 m² të ngastrës nr. 1b, e cila benë pjesë në ekonominë pyjore Balaj-Mollas, ndodhur në Njësinë Administrative Karbunarë, për një afat 10 (dhjetë) vjeçar.

II. Për lidhjen e kontratave të zbatohen proçedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, datë 9.6.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

PËR ZYREN E MENAXHIMIT TË ASETEVE

Sara Manoku

Liri Murati

DR. DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE